


USHTRIMET NË MIKROEKONOMI

Ass. Neshat Podvorica

1. Vendosi këto fjalë në vendet përkatëse në tre pyetjet e para: (*Qeveria, puna, çka të prodhohet, firmat, si të prodhohet, toka, familja, për kë të prodhohet, kapitali*)

- Numro faktorët e prodhimit: A _____; B _____; C _____.
- Agjentët ekonomik janë: A _____; B _____; C _____.
- Tre problemet ekonomike janë: A _____; B _____; C _____.

2. Sa është kostoja oportune nëse rritet sasia e prodhimit nga 2 në 3 njësi, llogarite?



3. Në fjalinë e mëposhtme ka pohime pozitive dhe normative, identifikoj cila është normative dhe pozitive:

“Problem i madh është papunësia në Kosovë e cila është 35 përqind, papunësia duhet të ulet sa më shpejtë që është e mundur”.

4. Faktorët që ndikojnë në zhvendosjen e kërkesës?

a. _____

b. _____

c. _____

d. _____

e. _____, mos harroni këta faktorë ndikojnë njëherit për zhvendosjen e kërkesës djathtas dhe majtas varësisht se kemi të bëjmë për rritje apo zvogëlim të saj.

5. Lidhja te oferta në mes të çmimit dhe sasisë është _____, ndërsa lidhja te kërkesa në mes të çmimit dhe sasisë është _____.

6. Paraqit të dhënat në vijim në grafikon dhe trego se në çfarë çmimi dhe sasia arrihet ekuilibri?

Çmimi	Sasia		Çmimi	Sasia
3	10		3	25
2	18		2	18
1	24		1	11

7. Faktorët që ndikojnë në zhvendosjen e ofertës?

a. _____

b. _____

c. _____


d. _____

e. _____, mos harroni këta faktorë ndikojnë njëherit për zhvendosjen e ofertës djathtas dhe majtas varësisht se kemi të bëjmë për rritje apo zvogëlim të saj.


8. Çfarë nënkuptoni me çmimin tavan dhe me çmimin dysheme?

Paraqit grafikisht:

Rasti i çmimit dysheme (minimal)



Rasti i çmimit tavan (maksimal)



9. Tepricë kemi atëher kur çmimi është më i _____ se çmimi i ekuilibrit ndërsa mungesë kemi kur çmimi është më i _____ se sa çmimi i ekuilibrit.